



**BASHKIA KAMEZ**

**DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE INVESTIMEVE**

**RELACION TEKNIK:**

***“ SHETITORJA FRUTIKULTURE ”***

**Punuan :**

Ing. Erblin LALA

Ing. Denis PRENCI

**Dr. e Projekteve dhe Investimeve**

Ing. Flora MUÇA

**MIRATOI**



## PROJEKTI “ SHETITORJA FRUTIKULTURE ”

### Bilanci i territorit

Sipërfaqja e ndërhyrjes	8450 m <sup>2</sup>
Sipërfaqe e Asfaltuar (Korsi Bicikletash)	1700 m <sup>2</sup>
Sipërfaqe Beton i stampuar	6400 m <sup>2</sup>
Nga te cilat Sipërfaqe e Gjëlburuar dhe Kënde Çlodhje	845m <sup>2</sup>
Mure Rrethuese me beton	2200 ml

**Përshkrim:** Zona ku do të realizohet ”shetitorja Frutikulture” karakterizohet kryesisht nga banesa nje familjare 1 dhe 2 kate te ndertuara ne menyre informale pas renies se regjimit komunist. Gjithashtu ne zone nder vite jane kryer dhe aktivitet bujqesore familjare ne parcelat e pandertuara.

Me qellim te permiresimit te infrastruktures ne zone, krijimit te hapsirave rekreative si dhe rritjen e atraksionit per zhvillim ne te ardhmen eshte parashikuar te realizohet nje shetitore me seksione pedonale dhe me korsi te dedikuara per bicikleta. Kjo shetitore gjithashtu do te kete dhe 4 sheshe ku do te pozicionohen ambjente clodhese dhe lojra per femije.

### Gjendja Ekzistuese

Aktualisht rruga ku parashikohet te ndertohet kjo shetitore eshte pjeserisht e hapur si trase dhe e shtruar sipas seksioneve me dhe te ngjeshur ose me cakull. Ne disa seksione ajo eshte e bllokuar nga gardhe rrethuese te realizuara nga vet banoret e zones.

Megjithese zona eshte zhvilluar kryesisht me banesa njefamiljare informale prania e nje plani rrugore te hershem ka shmangur ndertimin e banesave ne aksin e kesaj rruge e cila konvertohet ne shetitore. Gjeresia e rruges aktualisht varion nga 2.0m ~ 6.5m.

Ne kete aks aktualisht rrjetet inxhinierike te kanalizimeve te ujrave te zeza dhe furnizmit me uje te pishem jane te pjesshme dhe te realizuara ne menyre te improvizuar. Gjithashtu rrjeti i sistemimit te ujrave te shiut mungon plotesisht.

Nuk ka te zbatuar asnje standard dhe kusht teknik per mbrojtjen kundra zjarrit.

**Vlerësimi fizik:** Gjatë viteve të fundit ne këtë bllok banimi, rezulton se:

- Rrugët janë të hapura si trase pjeserisht dhe te shtruara me dhe te ngjeshur ose cakull;
- Trotualet nuk ekzistojne ;
- Sistemi i largimit të ujrave te shiut nuk ekziston,

- Parkimi është kryesisht individual brenda oborreve.
- Hapësirat e përbashketa nuk ekzistojnë.
- Rrjeti i furnizimit me ujë dhe i shkarkimit të ujrave të zeza është pjesërisht funksional.

**Objekt i projektit do të jetë Konvertimi i 2 akseve rrugore dytesore midis rruges Rruges "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" dhe Rruges "Iliria" në shetitore dhe korsi bicikletash. Gjithashtu do të ndërtohen dhe 4 sheshe rekreative me parqe lojërash për fëmijë.**

**Kjo ndërrje parashikon të kryej dhe sistemimin e ujërave të shiut, ndricimin rrugor, sinjalistikën, vendosjen e stolave, gaebo dhe kosha mbeturinash.**

**Me këtë ndërhyrje sigurohet përmirësimi i infrastrukturës në zonë dhe rritjen e atraksionit të zonës duke krijuar hapsira komunitare.**





*Fig.1 Foto Ekzistuese*


### **Përshkrimi i Projektit**

Me realizimin e këtij projekti do të ndërtohet një shetitore me një aks kryesor Veri-Jug midis Rrugës Rrugës "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" dhe Rrugës "Iliria", me gjatësi 1060m e cila do të ketë një korsë bicikletash me gjerësi 1.6 m, një korsë pedonale me gjerësi 4.8m, dhe 4 sheshe me hapësira rekreative dhe vende lojrash


Gjithashtu kjo shetitore do të ketë dhe dy degezime në drejtimin Lindje-Perëndim që kufizohet me Rrugën Iliria dhe aksin kryesor të shetitores. Degezimi do të ketë gjatësi 190m dhe gjerësi të trasës pedonale prej 4.9m.

# 1. Elementet Kryesore te projektit



Prerje terthore skesioni Tip i segmentit kryesore te shetitores




Plani i pergjithshem i shetitores




Plani i nje segmenti Tip te shetitores



Prerje terthore skesioni Tip i segmentit dytesore te shetitores



Plani i sheshit Nr 3 pergjate aksit kryesore te shetitores



Shtresat e Seksionit pedonal dhe shesheve:

- Shtrese Beton i Stampuar (me zgare  $\Phi 8$ /cdo 25cm) t = 15cm
- Shtrese Cakull 2x15cm
- Toka Natyrale

Shtresat e Korses se Bicikletave:

- Asfaltobeton 3 cm
- Konglomerat Bituminoz 4 cm
- Shtrese Stabilizant 20 cm
- Shtrese Cakull 15 cm
- Toka Natyrale

- **Muret Rrethuese**

Ne te gjihe krahut e shetitores do te realizohen mure rrethuese me lartesi te ulet per te kryer konturnimin dhe ndarjen e shetitores nga parcelat private te banoreve.

- **Kanalizimet e ujrave te shiut**


Pergjate te gjith trasese do te realizohet rrjeti i ri i ujrave te shiut.

- **Ndricimi Rrugore**

Cdo 10m do te vendosen shtylla ndricimi metalike me lartesi 5m. Ato do te kene sistem te fikjes dhe ndezjes automatik me sensore.

- **Mobilimi Urbane**

Shetorja do te pajiset me sotola cdo 30~40m. Stolat do te jene dekorativ te realizuar me beton dhe me dru. Ne sheshet rekreative do te kete dhe gazebo te realizuar me strukture Druri dhe me cati druri me tjegulla. Seskionet e shesheve te dedikuara per lojra per femije do te kende dhe nje ndarje me kangjella metalike.





- **Gjelberimi**

Pergjate te gjithë shetores do te mbillen peme Bli dhe peme Qiparisa. Tek sheshet rekreative rrethimi nuk do te kryhet me mur betoni por do te realizohet me shkurre „Ligustra“ te mbjella ne menyre te vazhdueshme ne forme bariere.

- **Mjetet e emergjencës, mbrojtja nga zjarri.**

Duke qene se kjo shetitore ka karakter kembesore/bicikleta akses i mjeteve te emergjences eshte i limituar.



Me qellimin e permiresimit te sigurise rrugore dhe mbrojtjes se jetes njerezore nga askidentimet ne pozicione te pershtatshme te shetitores do te vendosen elemte te sinjalistikes.

Keto ndahen ne 2 kategori

- Elemente sinjalistike horizontale

Ne kete kategori do te kete vijeime me boje te bardhe fosforeshente per vijen ndarese midis dy drejtimeve ne korsine e bicikeltave dhe gjithashtu do te eivdentohet qellimi i kesaj korsie duke vizatuar bicikleta mbi asfalt. Gjithashtu drejtimi i stampimit te bicikletes do te orjentoj ciklistet dhe mbi drejtimin e levizshmerise se korsise.


Ne seksionet ku shetitorja intersektohet me rruget automobilistike do te kete vijeim me geometri me vija te kryqezuara (treguar ne projekt). Kjo zone do te jete "buffer" e dedikuar per kalimin e kembesoreve, ekuivalente me vijat e bardha.



- Elemente sinjalistike horizontale

Ne kete kategori do te vendosen shtylla metalike me sinjalistike ku tregohen rregullat e detyrueshme te qarkullimit per bicikletat dhe automjetet. Ato do te fiksohen me beton dhe do te pozicionohen ne vende lehtesisht te dukshme.

Lartesia e tabelës së postme (ne raste kur ka me shume se 1 ne te njejten shtylle), duhet te jete jo me pak se 2.2m per te evituar aksidentimin e kalimtareve.




#### - Elementet Kryesore te projektit

Sistemimi i ujrave atmosferike do te kryhet pergjate te gjithë shetitores. Ky funksion do te arrihet nepermjet sistemit te ri te kanalizimeve te ujrave te bardha dhe elementeve te tjere disiplinues per ujrät siperfaqesore.

Me konkretisht te gjitha sipefaqet e shetitores do te kene pjerresi 2% ne drejtim te nje kunete betoni e cila ne aksin kryesore Veri-Jug do te jete e pozicionuar midis korsis se bicikletave dhe zones kembesore me beton te stampuar. Kjo kunete ne degezimin dyesore Lindje-Perendim do te jete e pozicionuar ne sjain veriore te shetitores.

Ne seksione te pershtatshme pergjate kunetes me beton (cdo 25m) do te kete puseta K.U.B me kapak "Zgare" kompozit. Me ane te ketyre pusetave ujrät nga rreshjet do te transferohen nentoke ne rrjetin e kanalizimeve te cilat lidhen me rrjetin ne rrugët ekzistuese me te cilat intersektohet shetitorja

Per realizimin e lidhjes se rrjetit ne seksionet ku intersektohet shetitorja me rrugët automobilistike ekzistuese eshte e nevojshme te kryhen punime mbi keto ruge. Me konkretisht do te hapen kanale me thellesi te specifikuara ne projekt. Ne perfundim te punimeve keto seksione dutet te riparohen dhe te riasfaltohen per ti kthyer ne gjendjen e meparshme.



Tubat e përdorur për rrjetin do të jenë **HDPE 200 mm të brinjëzuar**. Dimensi i tyre është përllogaritur në baze të prurjeve maksimale nga rreshjet të parashikuara në studimin hidrologjik.

Pjerrësia minimale e lejuar për këto tuba do të jetë 0.7%, e cila është e parashikuar vetëm në disa seksione të linjes në projekt.

Me poshtë po tregohen detaje të pushtave KUSH, të vendosjes së tubit HDPE 200mm dhe të kunetes.

